



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave-KRM "Pastrimi" Sh.A të datës 11.01.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.01.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KOMPANISË RAJONALE TË**  
**MBETURINAVE "PASTRIMI"SH.A**

**Neni 1**

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 17,760.00 € (shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë euro), për ta mbështetur financiarisht përkatësisht subvencionuar pjesërisht –pagesën e borxhit që ka KRM "Pastrimi" ndaj Kreditorit KMDK Sh.A, konform dispozitave të Vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave-KRM "Pastrimi" Sh.A të datës 11.01.2023 .

II. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfere të planifikuara për vitin 2023 në xhironlogarinë bankare të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave " Pastrimi"SH.A .

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

IV. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

15 Nr. 400/dl-5614  
Lipjan, më 31.01.2023

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

Kryesuesi i Kuvendit  
**Daut Azemi**

